

VENDIM
Nr. 42, datë 30.1.2019

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN
NR. 153, DATË 7.4.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
RREGULLORES PËR ZBATIMIN E KODIT RRUGOR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 198, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në rregulloren për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me vendimin nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Pas pikës 4, të nenit 349, shtohen pikat 5 dhe 6, me këtë përmbajtje:

“5. Procesverbali i prodhuar nga pajisjet digjitale është sipas modelit VI.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje dhe duhet të përmbajë të njëjtët tregues të procesverbalit të modelit VI.1 të saj.

6. Modalitetet e përdorimit të pajisjeve digjitale dhe mënyrat e transferimit të të dhënave digjitale në kohë reale në sistemin elektronik e-gjyba përcaktohen me udhëzim të ministrit të Brendshëm.”.

b) Pas modelit VI.1 shtohet modeli VI.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MODEL VI.2



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E BRENDSHME
PROÇES VERBAL I KONSTATIMIT TË SHKELJES
Nr Serial:
ID Oficeri:

DATA/VENDI

Data: | Ora:

Adresa:

SHKELËSI

JO PREZENT

MJETI

Marka: | Targa:

Tipi: | Kapaciteti:

PRONARI

Emër Mbiemër:

Adresa:

SHKELJA

SANKSIONI

Të gjobitet me:

Pasesa behet brenda 5 diteve kur merr forme te prane. Me kalimin
it paguhet 2% kamat ne dite. Kodi i llogaritese ekonomike te kamatit
te Jete P125588.

Kodi i Institucionit: 1016020

Kodi i Deses se Thesarit: 3535

Kodi i Llogaritese Ekonomike: 7115410

SHKELËSI

PUNONJËSI I POL